



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 02 / 423 Dt. 23 / 02 / 2024

Në mbështetje të nenit 22, paragrafi 1, pika 2, të Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues të UKZ-së, nr.02/2900 të datës 19.12.2023, Këshilli Drejtues në mbledhjen e XXXIII të mbajtur më datë 14.02.2024, mori:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të buxhetit për Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, për periudhën një vjeçare prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Raporti Nr. 05/238 të dt. 26.01.2024.



Kryesuese e KD-së

PhD.cand. Arta Istrefi

Vendimi t'i dërgohet:

1. Rektorit të UKZ-së;
2. Prorektorit për Buxhet dhe Financa
3. Sekretarit të Përgjithshëm
4. Zyrës së Financave
5. Arkivit të Universitetit



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" PUBLIC UNIVERSITY

Rr.Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 05 / 238 Dt. 26 / 01 / 2024

RAPORTI VJETOR I BUXHETIT 2023

Gjilan, Janar 2024

Përmbajtja	2
HYRJE	3
1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	4
1.1. Baza e përgatitjes së raportit.....	4
1.2. Politikat e kontabilitetit	4
1.3. Subjekti raportues	5
2. FONDET BURIMORE TË BUXHETIT NË UKZ	8
2.1. Fondi Burimor 10 (Grandi Qeveritar)	8
2.2. Të hyrat vetanake	9
2.3. Të hyrat nga projektet ndërkombëtare.....	10
2.4. Donacionet (të hyrat) dhe Shpenzimet	10
3. KATEGORITË KRYESORE TË BUXHETIT	11
3.1. Paga dhe shtesa.....	11
3.2. Mallra dhe shërbime	12
3.3. Shpenzimet komunale.....	15
3.4. Subvencionet dhe transfere.....	16
3.5. Shpenzimet kapitale.....	17
4. PËRFUNDIMET.....	18

HYRJE

Raporti vjetor i buxhetit paraqet një dokument përmbledhës të buxhetit të UKZ-së për të hyrat dhe shpenzimet, që përfshin periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Ky raport vjetor i buxhetit karakterizohet me menaxhimin e buxhetit në dy periudha kohore nga dy rektor dhe atë, Janar-shtator/2023 nga ish rektori Bajram Kosumi dhe Tetor-dhjetor/2023 nga rektori aktual Artan Dërmaku.

Zyra për buxhet dhe financa në bashkëpunim me certifikuesin e shpenzimeve dhe Raportin e zyrës së prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi përgaditë Raportin e detajuar financiar të buxhetit të për të hyrat dhe shpenzimet të çështjeve kyçe në fushën e menaxhimit financiar që përfshin periudhën kohore kalendarike 01.01.2023 deri më 30.12.20123.

Raporti financiar i buxhetit për periudhën raportuese i dërgohet sekretarit të përgjithshëm, i cili raport përmes Prorektorit për buxhet, financa dhe infrastrukturë i dërgohet rektorit.

Rektori paraqet në KD Raportin financiar të buxhetit sipas periudhave raportuese për shqyrtimin dhe miratim nga KD-së.

Raporti përmban katër pjesë kryesore:

- 1) Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël,
- 2) Fondet burimore të buxhetit të UKZ-së
- 3) Kategoritë kryesore të buxhetit, dhe
- 4) Përfundimet

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

1.1. Baza e përgatitjes së raportit

Raporti është përgatitur në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr.03/L-048) dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit (Nr.03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr. 03/L-221), neni 46 dhe Ligjit (Nr. 04/L-116) për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit (Nr. 03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin (Nr.03/L-221), dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme – *Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.*

1.2. Politikat e kontabilitetit

Baza e kontabilitetit dhe raportimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këtë raport paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i kontrollon një institucion i vetëm – Thesari.

Pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur janë nën kontroll të Qeverisë. Kjo, përfshinë paratë të cilat janë transferuar në llogari të Thesarit në BQK, paratë që qëndrojnë në llogari nëpër banka komerciale në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e një organizate buxhetore në pritje për tu transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato paguhen nga llogaria e vetme e Thesarit.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës.

1.3. Subjekti raportues

Raporti financiar paraqet aktivitetin financiar të Qeverisë së Kosovës ashtu siç është specifikuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048) ku përfshihen të gjitha **organizatat buxhetore**, MASHT-i, si dhe nën-program i saj, **Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan**.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” përbëhet prej pesë njësive akademike:

1. Fakulteti i Edukimit
2. Fakulteti Juridik
3. Fakulteti Ekonomik
4. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe
5. Fakulteti i Shkencave Aplikative

Fakultetet e Universitetit janë të ndara në departamente në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit. Të gjitha Fakultetet ofrojnë studime të rregullta të nivelit Bachelor dhe Master në përputhje me dispozitat e Statutit të Universitetit.


Buxheti i UKZ-së është i ndarë në mënyrë Institucionale, në të cilin janë të përfshira të gjitha njësitë akademike.

Në tabelën nr. 1 është i paraqitur buxheti dhe shpenzimet deri më 31.12.2023 si dhe struktura e shpenzimeve në raport me buxhetin total.

Tabela 1: Buxheti dhe Shpenzimet Janar – Dhjetor 2023

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2023 Granti Qeveritar	Strukt. Kateg. %	Shpenzimet 2023 31.12.2023	Përqind. e shpenzimit %
Paga dhe Shtesa	1,420,281.00 €	65%	1,435,730.51 €	101.09%
Mallra dhe Shërbime	476,923.00 €	21.71%	314,609.78 €	65.97%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	2.28%	15,311.81 €	30.62%
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	4.55%	73,311.67 €	73.31%
Pasuritë jo Financiare (Kapitale)	150,000.00 €	6.83%	113,957.47 €	75.97%
Totali	2,197,204.00 €	100%	1,952,921.24 €	88.88%

Në vijim, do të paraqesim pasqyrën grafike të buxhetit dhe realizimit të tij për periudhën raportuese (Janar – Dhjetor 2023):



Duke u bazuar në tabelën e mësipërme dhe shpenzimeve të planifikuara të UKZ-së, alokimi i këtij buxheti është bërë si në vijim:

Table 2: Buxheti dhe alokimi i buxhetit

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2023	Alokimi i Buxhetit deri me 31.12.2023	Përqindja e buxhetit të alokuar
Paga dhe Shtesa	1,420,281.00 €	1,435,730.51 €	101.09%
Mallra dhe Shërbime	476,923.00 €	476,923.00 €	100.00%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	100.00%
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	100,000.00 €	100.00%
Pasuritë jo financiare (Kapitale)	150,000.00 €	150,000.00 €	100.00%
Gjithsej	2,197,204.00 €	2,212,653.51 €	100.70%

Nga tabela e mësipërme shihet se buxheti në total është alokuar në lartësinë prej **100.70 %**.

Ky alokim i buxhetit ka ndodhur në këto kategori shpenzimesh:

- **Alokimi i pagave** është bërë në masën **101.09 %** të buxhetit total për këtë kategori.
- **Mallrat dhe shërbimet:** janë alokuar në masën prej **100.00 %**. Përmes kësaj kategorie UKZ-ja paguan shpenzimet fikse ashtu edhe ato variabile si p.sh. kontratat për pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, pagesa për sigurimin fizik, mirëmbajtja e sistemeve elektronike, shërbimet kontraktuale, pagesa e mbushjeve të telefonave mobil, avance për udhëtime zyrtare, shërbimet teknike etj.
- **Shpenzimet komunale** janë alokuar duke u bazuar në shpenzimet e vitit paraprake si dhe në përpjesëtim mujor 1/12 për vitin aktual. Të gjitha pagesat realizohen përmes faturave. Këtu hyjnë të gjitha pagesat xhiro si: Pagesa e energjisë elektrike, pagesa e ujësjellësit, pagesa për mbeturina si dhe pagesa për telefona fiks. Shpenzimet komunale për 12 mujor janë alokuar **100.00 %**.
- **Transferimet dhe subvencionet,** alokimi është bërë në masën **100.00 %**, përmes kësaj kategorie bëhet pagesa e bursave për studente, mbështetja e punimeve shkencore për stafin akademik, mbështetje financiare për aktivitete (mobilitet, gara, etj) për studentët e UKZ-së.
- **Shpenzimet kapitale,** është bërë në masën prej **100.00 %**.

Më poshtë kemi paraqitur alokimin 12 mujor të buxhetit në raport me shpenzimet e kësaj periudhe si dhe raportin e shpenzimeve 12 mujore me buxhetin në tërësi:

Table 3: Raporti Buxheti – Alokimi - Shpenzimet

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2023	Alokimet	Shpenzimi	Raporti % shpenzime- alokimin 2023	Raporti % shpenzime- buxhetin 2023
Paga dhe Shtesa	1,420,281.00 €	1,435.730.51 €	1,435,730.51 €	100.00%	101.09%
Mallra dhe Shërbime	476,923.00 €	476,923.00 €	314,609.78 €	65.97%	65.97%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	15,311.81 €	30.62%	30.62%
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	100,000.00 €	73,311.67 €	73.31%	73.31%
Pasuritë jo financiare (Kapitale)	150,000.00 €	150,000.00 €	113,957.47 €	75.97%	75.97%
Gjithsej	2,197,204.00 €	1,585,974.31 €	1,952,921.24 €	88.26%	88.88%

Nga shënimet e sipërcekura mund të vërehet se shpenzimet e realizuara krahasuar me alokimin e mjeteve janë bërë në lartësi prej **88.26 %**.

Ndërsa, Universiteti Publik “Kadri Zeka”, gjatë periudhës raportuese, e ka shpenzuar buxhetin në masën prej **88.88 %**.

2. FONDET BURIMORE TË BUXHETIT NË UKZ


Gjatë kësaj periudhe raportuese Janar – Dhjetor 2023, shpenzimet e Universiteti Publik “Kadri Zeka” përbëhet nga dy fonde burimore, siç janë:

2.1. Fondi Burimor 10 (Grandi Qeveritar)

Table 4. Fondet burimore

Fondet Burimore	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2023
Fondi Burimor 10	1,952,921.24 €
Të hyrat vetanake	34,523.00 €
Fonrdi Burimor 49	190,293.79 €
Totali	2,143,215.03 €

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes shpenzimet e fondeve burimore në UKZ-së:




2.2. Të hyrat vetanake

Universiteti “Kadri Zeka” për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2023 ka krijuar të hyra vetanake prej **34,523.00 euro** – Partecipimet e studentëve të UKZ-së.

Table 5: Të hyrat vetanake

Të hyrat Vetanake	Janar - Dhjetor 2023
Janar	1,675.00 €
Shkurt	1,528.50 €
Mars	6,801.50 €
Prill	392.50 €
Maj	915.00 €
Qershor	1,628.50 €
Korrik	2,097.50 €
Gusht	67.50 €
Shtator	1,360.50 €
Tetor	11,993.50 €
Nentor	4,818.00 €
Dhjetor	1,245.00 €
Totali	34,523.00 €

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes të të hyrave vetanake:



2.3. Të hyrat nga projektet ndërkombëtare

Universiteti “Kadri Zeka” ishte pjesë aktive e 9 projekteve, në Erasmus + CBHE, 1 si grant mbajtës / koordinator dhe 8 projekte si partner me Universitetet tjera.

Mirëpo, disa nga projekte janë në fazën e përfundimit gjatë vitit 2023, siç janë: Quadric, E-Viva, SMAHDPC, Enemlos, Qatek dhe ReacherCult.

Gjatë vitit 2023 Universiteti “Kadri Zeka” ka fituar 3 projekte të reja, ku ka filluar edhe zbatimin i tyre gjatë këtij viti, në kuadër të **ERASMUS+**:

- WebJou - Partneritet me Universitetin e Mostarit
- GreenWB - Partneritet me Shqipërin
- Suswell - Holand

Universiteti “Kadri Zeka” është lidere (Kordinator) e projektit **QUADIC – Quality development of international cooperation and project management** dhe ky projekt ka pasqyruar edhe gjithsejtë 17 partner vendor, regjional dhe ndërkombëtar, dhe po financohet nga Komisioni Evropian në vlerë prej **991.381.00 Euro**.


2.4. Donacionet (të hyrat) dhe Shpenzimet

Në kuadër të projekteve për periudhës raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2023), kemi këto shpenzime në disa projekte, si janë:

Table 6: Shpenzimet e projekteve (fondi burimor 49)

Emërtimi i projekti	Të hyrat (donacionet) Janar – Dhjetor 2023	Shpenzimet totale (projektet) Janar - Dhjetor 2023
QUADIC	39,471.69 €	99,866.92 €
QATEK	-	14,732.00 €
E - VIVA	9,754.34 €	9,947.03 €
ENEMLOS	-	14,116.86 €
REACHERCULT	-	1,559.36 €
SMAHDPC	4,822.50 €	4,949.00 €
SIAHDPC	8,901.00 €	18,593.18 €
STEAMEDU	-	2,976.00 €
WEBJOU	36,099.82 €	7,263.40 €
GREENWB	461.10 €	-
STAND	27,873.60 €	16,290.04 €
TOTALI	127,384.05 €	190,293.79 €

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes së shpenzimeve të projekteve:



3. KATEGORITË KRYESORE TË BUXHETIT

3.1. Paga dhe shtesa


Në kategorinë “Paga dhe shtesa”¹, për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar gjithsejtë **1,435,730.51 €**. Këtu përfshihen pagesa neto e pagave, honorarëve, mbi normave, pagesa për kontribute pensionale 5% si dhe pagesa e tatimit të ndalur në burim për të gjithë punonjësit e rregullt të UKZ-së. Vlen të theksojmë që në këtë kategori nuk përfshihen punonjësit me kontratë për shërbime të veçanta dhe të gjitha pagesat tjera për punonjës jashtë listës – sistemit qeveritar të pagesave (PAY ROLL). Në kuadër të kësaj vlere prej **1,435,730.51 euro** këtu janë përfshir edhe shtesat dhe mbinorat e stafit akademik dhe administrativ shtesat për periudhën dhjetor të vitit 2022 në vlerë prej **49,792.90 euro** të cilat këto shtesa janë kompenzuar në Janar të 2023.

¹ Bartja e shpenzimeve nga fondi 10 në fondin 21 dhe 22 ka ndodh në dy periudha për kategorinë e pagave, një në muajin **Nëntor në vlerë prej 15,106.00 euro** dhe në muajin **Dhjetor në vlerë prej 13,354.00 euro**.

Table: 7 Paga dhe shitesa

Përshkrimi	Shpenzimi nga BKK
Neto pagat	1,194,866.71 €
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi	66,238.33 €
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar	66,238.33 €
Tatimi në të hyra personale	107,446.98 €
Pagesa per sindikat	940.16 €
Totali	1,435,730.51 €

Në vijim po paraqesim pasqyrën grafike për shpërndarjen e pagave bruto:



3.2. Mallra dhe shërbime


Në këtë kategori janë alokuar mjetet në masën prej **100.00 %**. Përmes kësaj kategorie UKZ-ja janë paguar shpenzimet fikse ashtu edhe ato variabile si p.sh. Kontratat për pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, mirëmbajtja e sistemeve elektronike, shërbimet kontraktuale, pagesa e mbushjeve të telefonave mobil, avance për udhëtime zyrtare etj.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, për periudhën raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2023), janë shpenzuar gjithsejtë **314,609.78 €**.

Table 8: Mallra dhe Shërbime

Kategoria e shpenzimit	Totali	Përqindja %
Shërbimet e telekomunikimit - Vala (mbushjet tel për menaxhmenti dhe faturat mujore për rrethin e administratës në ukz)	7,015.96 €	2.23%
Meditje	3,113.35 €	0.99%
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	7,709.99 €	2.45%
Shpenzimet tjera të udhëtimit jashtë vendit	3,219.44 €	1.02%
Shpenzimet brenda vendit dhe akomodimi brenda vendit	830.00 €	0.26%
Shërbime shtypje-jo marketing	2,289.70 €	0.73%
Shërbimet kontraktuale (kontibutet pensionale 5% për të angazhuarit në projekte), pagesat e tatimi në burim, etj	22,072.22 €	7.02%
Shërbime teknike (Pagesa për sistemin elektronik të menaxhimit të studenteve SMU) mujore 2,750.00 euro	41,172.00 €	13.09%
Pajisjet tjera, mobile (IT etj.)	20,286.96 €	6.45%
Furnizim me pije	1,145.26 €	0.36%
Mirëmbajtja e Autoveturave dhe Riparimi i automjeteve	2,949.00 €	0.94%
Sigurimi i Objektit (mujore 2,276.83 euro)	27,321.51 €	8.68%
Karburant për vetura	2,724.68 €	0.87%
Shpenzimet e Internetit	2,688.96 €	0.85%
Mirëmbajtja e objektit (pastrimi), mujore 4,497.82 euro, etj	57,524.09 €	18.28%
Shpenzimet e reprezentacionit	10,576.62 €	3.36%
Shpenzimet për anëtarësim (antarësimi ALFA dhe AISBL)	2,790.00 €	0.89%
Furnizim për zyre	13,772.74 €	4.38%
Reklama dhe Konkurse	98.00 €	0.03%
Regjistrimi i Automjeteve	1,168.99 €	0.37%
Karburant për ngrohje qendrore	83,877.71 €	26.66%
Mirëmbajtje rutinore	250.00 €	0.08%
Shërbime postare	12.60 €	0.00%
Totali	314,609.78 €	100.00%

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes e kategorive kryesore në mallra dhe shërbime:



3.3. Shpenzimet komunale


Shpenzimet komunale janë shpenzuar në bazë të faturave dhe përbëjnë shpenzime që ndodhin çdo vit, thuajse në masën e njëjtë, pa ndryshime të mëdha. Në këtë kategori për periudhën raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2023), janë shpenzuar gjithsejtë **15,311.81 €**.

Prandaj, në vijim është paraqitur tabela me shpenzime për secilin operator ekonomik.

Table 9: Shpenzimet komunale

Kategoria e shpenzimit	Mjetet e shpenzuar Janar - Dhjetor 2023
Telefonia fikse	1,557.67 €
Keds	10,876.18 €
Hidromorava	2,145.59 €
Eco-higjiena	732.37 €
Totali	15,311.81 €

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes së kategorive kryesore në shpenzimet komunale:




3.4. Subvencionet dhe transfere

Në këtë kategori bëhet pagesat e bursave për studentët e dalluar, mbështetja e kërkimeve dhe publikimeve shkencore për stafin akademik, shkencari i vitit, si dhe aktivitete të ndryshme gara, recitimet, përfaqësime nga studentet, mobilitet etj.

Nga kjo kategori për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar mjetet prej **73,311.67 €**.

Table 10: Shpenzimet Subvencione dhe transfere

Kategoria e shpenzimit	Mjetet e shpenzuar Janar - Dhjetor 2023
Bursat e stundeteve 2023	58,400.00 €
Garat e studenteve	220.00 €
Perfaqesimi i studenteve ne garat ne Shqiperi	250.00 €
Perfaqesimi i studenteve ne Universitetin Ph Zug	4,900.00 €
Punimet shkencore, hulumtuesi i vitit 2022, konferenca stafi akademik, etj	9,541.67 €
Totali	73,311.67 €



3.5. Shpenzimet kapitale

Për vitin 2023, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në kategorinë kapitale ka buxhetin e ndarë në vlerë prej **150,000.00 Euro**. Kjo kategori posedon 3 projekte kapitale, si në vijim:


1. Ndërtimi i kampusit të UKZ-së në shumë prej **100,000.00 Euro**,
2. Blerja e mobiljeve në UKZ në shumë prej **20,000.00 Euro** si dhe
3. Blerja e pajisjeve laboratorike dhe të Teknologjisë Informative në shumë prej **30,000.00 Euro**.

Në këtë kategori për periudhën raportuese 12 mujore, kemi realizuar shpenzime e buxhetit në vlerë prej **113,957.47 €**.

Table 11: Shpenzimet kapitale

Nr. Rendor	Projekti	Buxheti 2023	Mjetet e shpenzuara	Përqindja %
1	Ndërtimi dhe Renovimi i Infrastrukturës së UKZ-së - 14039	100,000.00 €	92,757.47 €	92.76%
2	Blerja e mobiljeve në UKZ - 14047	20,000.00 €	4,250.00 €	21.25%
3	Paisje të IT-së - 15256	30,000.00 €	16,950.00 €	56.50%
	Totali	150,000.00 €	113,957.47 €	75.97%

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes së kategorive kryesore në shpenzimet kapitale:



4. PËRFUNDIMET

Buxheti i Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është nën-program në kuadër të organizatës buxhetore të MASHTI-it. Buxheti është i ndarë në mënyrë Institucionale, në të cilin janë të përfshira të gjitha njësitë akademike. Gjithsejtë Buxheti i vitit 2023 është në shumën **2,197,204.00 €** dhe i shpenzuar në shumën **1,952,921.24 €**, shprehur në përqindje **88.88%**.

Në vijim në formë përmbledhëse paraqitet sipas kategorive buxhetore , struktura së shpenzimeve në raport me buxhetin total deri më 31.12.2023.

1. **Në kategorinë Paga dhe Shtesa**, janë alokuar në masën prej **101.09 %** për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar gjithsejtë **1,435,730.51 €**. Këtu përfshihen pagesa neto e pagave, honorarëve, mbi normave, pagesa për kontribute pensionale 5% si dhe pagesa e tatimit të ndalur në burim për të gjithë punonjësit e rregullt të UKZ-së. Në kuadër të shpenzimeve nga kjo kategori janë përfshirë edhe shtesat dhe mbinorat e stafit akademik dhe administrativ shtesat për periudhën dhjetor të vitit 2022 në vlerë prej **49,792.90 euro** të cilat këto shtesa janë kompensuar në Janar të 2023. Vlen të theksojmë që në këtë kategori nuk përfshihen punonjësit me kontratë për shërbime të veçanta dhe të gjitha pagesat tjera për punonjës jashtë listës – sistemit qeveritar të pagesave (PAY ROLL).
2. **Mallrat dhe Shërbimet:** janë alokuar në masën prej **100.00 %**. Përmes kësaj kategorie UKZ-ja paguan shpenzimet fikse ashtu edhe ato variabile si p.sh. Kontratat për pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, mirëmbajtja e sistemeve elektronike, shërbimet kontraktuale, pagesa e mbushjeve të telefonave mobil, avance për udhëtime zyrtare etj. Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, për periudhën raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2023), janë shpenzuar gjithsejtë **314,609.78 €**.
3. **Shpenzimet Komunale** janë alokuar **100.00 %**. Në këtë kategori të gjitha pagesat realizohen përmes faturave si p.sh: pagesa e energjisë elektrike, pagesa e ujësjellësit, pagesa për mbeturina si dhe pagesa për telefona fiks. Në këtë kategori për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar gjithsejtë **15,311.81 €**.

- 4. Subvencione dhe Transfere** – janë alokuar mjetet në shumë **100.00 %**. në kategorinë subvencione dhe Transfere për periudhën raportuese 12 mujore. Me këtë kategori bëhet pagesa e bursave për studentët e dalluar, mbështetja e kërkimeve dhe publikimeve shkencore për stafin akademik, hulumtuesi i vitit, si dhe aktivitete e ndryshme si gara dhe recitimet nga studentet. Në këtë kategori për periudhën raportuese 12 mujore kemi shpenzuar mjetet në shumë prej **73,311.67 €**.
- 5. Shpenzimet Kapitale** - Alokimi në kategorinë Investimeve kapitale është bërë në masën prej **100.00 %**. Për vitin 2023, Universiteti “Kadri Zeka” në kategorinë e investimeve kapitale ka buxhetin e ndarë në vlerë prej **150,000.00 euro** (Ndërtimi i kampusit të UKZ-së) në shumë prej **100,000.00 Euro**, Blerja e mobilieve në UKZ në shumë prej **20,000.00 Euro** si dhe Blerja e pajisjeve laboratorike dhe të Teknologjisë Informative në shumë prej **30,000.00 Euro**). Realizimi i shpenzimeve nga kjo kategori për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2023 janë në vlerë prej **113,957.47 €**.
- 6. Të hyrat Vetanake** janë mjete financiare që grumbullohen duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës si dhe Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovës. Këto të hyra grumbullohen nga pagesat e studentëve si: pagesa e semestrit, pagesat e vërtetimeve, pagesat e certifikatave, pagesat e regjistrimeve etj. Shuma totale e të hyrave gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2023 është **34,523.00 € Euro**.
- 7. Projektet e UKZ-së** – Universiteti publik “Kadri Zeka” në Gjilan, është Koordinator e projektit QUADIC nga Erasmus+, dhe është bashkë partnere në disa projekte të tjera. Në kuadër të projekteve për periudhës raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2023), kemi këto shpenzime në disa projekte, si janë: QATEK (14,732.00 euro), E-VIVA (9,947.03 euro), ENEMLOS (14,116.86 euro), REACHERCULT (1,559.36 euro), STEAMEDU (2,976.00 euro), SIAHDPC (18,593.18 euro), SMAHDPC (4,949.00 euro), STAND (16,290.04 euro), WEBJOU (7,263.40 euro) dhe QUADIC (99,866.92 euro).